# I maskuar dhe i armatosur, autori qëlloi në ajër dhe grabiti 4.6 mln lekë në postën e Bulqizës, sapo kishin ardhur nga qendra (VD)

**Grabitet Posta Shqiptare në mes të ditës, miliona para ikën për sigurinë dhe ruajtjen**

**Ngjarja ka ndodhur mesditën e sotme. Ende nuk dihen detaje lidhur me shumën e parave të grabitur apo edhe mbi autorët e përfshirë.**




22 Tetor, 2019 12:38

**FUSHË-BULQIZË-** Grabitet me armë zyra postare në Fushë-Bulqizë. Ngjarja ka ndodhur mesditën e sotme, sapo paratë e pensioneve dhe të ndihmës ekonomike kishin ardhur nga qendra.

Në momentin që blindi me paratë u largua, një person i maskuar ka qëlluar më armë zjarri në ajër dhe ka kërcënuar punonjësit e zyrës që t’i japin të gjitha paratë.

Mësohet se një person i maskuar ka marrë rreth 460 mijë lekë të reja dhe më pas është larguar me shpejtësi nga vendngjarja. Dyshohet se autori është banor vendas pasi i ka ditur me përpikmëri lëvizjet e blindit me para në postë.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook. **Dosja.al**




Siç duket edhe nga pamjet e Postës, dera është tërësisht e thyer dhe punonjësit janë ende në panik nga ngjarja e ndodhur.

Pas sinjalizimit për rastin, Policia dhe grupi hetimor kanë mbërritur menjëherë në vendngjarje ku edhe kanë nisur punën për kapjen e autorit.

(k.m/dosja.al)

DR LIGHT

ETIKETA: #fushe bulqize #grabitet posta ne fushe-bulqize

9
SHARES

Previous article

**Dështimi i negociatave me BE-në/ Basha i përgjigjet Ramës me Merkelin: Të refuzoi Europa, tani është koha të të refuzojnë shqiptarët**

Next article

**Vrau bashkëshortin për 1.5 mln paund? Akuzat që rëndojnë mbi ish-balerinën, e cilësuar si "Vejusha e Zezë**

Shto Koment

Emri Juaj*

E-Mail*